



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH

Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit: 02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.: 05-6913
Nr. i faqes Br. stranica No. listica: -38-
Datumi: 19.11.2013
Prishtine / z.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

Departamenti i Informimit / Departament za Informisanje / Department of Information

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	19/11				
PËR/ZA/TO:	Prof. Dr. Ferid Agani, Ministër i Shëndetësisë				
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Dr. Gani Shabani, Sekretar i Përgjithshëm				
NGA/OD/FROM:	Dr. Faik Hoti, Kryesues i Grupit punues për Planin e Komunikimit të Ministrisë së Shëndetësisë				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për aprovimin e Planit të Komunikimit dhe Planit të veprimit (2013-2016)				
Nr. i zyrës:	103	Lokacioni:	MSH	Data:	19.11.
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	2013
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS					<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					<input type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					<input type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input type="checkbox"/>
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					<input type="checkbox"/>

I nderuari z. Ministër,

Kemi kënaqësinë që t'u përcjellim për miratim Planin e Komunikimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Planin e Veprimit (2013-2016) për zbatimin e tij, i hartuar nga një grup pune i përbërë prej profesionistëve të niveleve të ndryshme shëndetësore, dhe i mbështetur edhe nga Qeveria e Luksemburgut përmes KSV -014 projektit.

Ky plan i hartuar kohë më parë, ka pritur të dorëzohet për miratim këtë moment, me që, i njëjti duhej të përshtatej me ndryshimet e reja në strukturën organizative të Ministrisë, të ri-organizuar sipas Rregullores për organizimin e brendshëm të saj, të miratuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, për t'u përshtatur edhe me riorganizimin e disa departamenteve e divizioneve dhe emërtimin e ri të tyre.

Megjithatë, shumë aktivitete të paraparë në këtë plan janë zhvilluar paralelisht me ndërtimin e tij, siç është zhvillimi i trajnimeve për zyrtarët e komunikimit, ri-dizajnimi dhe avancimi i web faqes së Ministrisë, emërimi i zyrtarëve në disa institucione shëndetësore për komunikim me publikun, caktimi i zyrtarëve për adresimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, përgatitja e shtandit informativ, zhvillimi i disa fushatave informative për ligje të caktuara të Ministrisë dhe të tjera.

Plani i Komunikimit i cili ndërtohet mbi tri shtylla: Komunikimin e brendshëm; Komunikimin e Ministrisë me institucionet e tjera; dhe Komunikimin me Publikun, vjen në një moment adekuat për MSh-në, si një dokument mbështetës për reformën shëndetësore.

Miratimi i Ligjit të ri të Shëndetësisë, Ligjit për Kontrollin e Duhanit, Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe hartimi i disa ligjeve të tjera që janë në procedurë të miratimit si Projektligji për Sigurime Shëndetësore dhe të tjera, kërkon që Plani i komunikimit të përafrohet plotësisht me këtë proces aktual të reformave.

MSh duhet të sigurohet që kjo reformë të kuptohet drejt dhe të shkojë në drejtimin e duhur, kurse Plani i Komunikimit është një instrument që do ta lehtësojë këtë.

Prandaj, duke vlerësuar se ky plan i thjeshtë, por praktik në zbatimin e tij, do të ndihmojë që të nxis punën ekipore në aspektin e komunikimit, koordinimit dhe angazhimit të statit të MSh, por edhe të MSh-së me institucionet e tjera dhe publikun, ju lusim që ta miratoni atë.

Me respekt,



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva- Ministry of Health

**PLANI I KOMUNIKIMIT DHE PLANI I
VEPRIMIT
(2013-2016)**

Nëntor, 2013

Grupi punues

Faik Hoti, kryesues, Ministria e Shëndetësisë

Ilir Begolli, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike

Sami Uka, Organizata Botërore e Shëndetësisë-Zyra në Prishtinë

Agron Gashi, UNICEF-Zyra në Prishtinë

Ibrahima Blondin Diop, Lux-Development

Artan Sadiku, Lux -Development

Drita Peçani, Kujdesi Parësor Shëndetësor, QKMF-Prishtinë

Shpend Fazliu, Qendra Klinike Universitare e Kosovës

Nora Krasniqi, Ministria e Shëndetësisë

Mbështetur nga Projekti KSV-014 i Qeverisë së Luksemburgut për fuqizimin e kapaciteteve të Ministrisë së Shëndetësisë

Fjala e Ministrit

Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, konsideron se roli i komunikimit në procesin e reformave të filluara në shëndetësi është jetik në përmbushjen e këtij misioni, ndërsa Plani i Komunikimit dhe Plani i Veprimit, esencial në sigurimin e një qasje të re në komunikim, me qëllim që të gjitha palët e përfshira, ta kuptojnë drejt dhe mbështesin reformën shëndetësore, ta ndihmojnë koherencën, konsensusin dhe kontinuitetin e saj.

Qëllimi i këtij Plani është që në mënyrë të strukturuar, të ndihmohen të gjitha palët që ta kuptojnë ecurinë e këtij procesi reformues përmes një komunikimi të integruar dhe të ndërsjellë të dhënies dhe marrjes së informacionit.

Roli i ri drejtues i Ministrisë së Shëndetësisë në sektorin shëndetësor, duke kaluar nga roli operativ dhe i menaxhimit të drejtpërdrejt të institucioneve shëndetësore në rol të ri drejtues, me fokusim në rol strategjik në krijimin e politikave shëndetësore, e shtron nevojën që përmes kësaj strategjie të komunikimit të sigurohet përkrahja e duhur

Në këtë drejtim, Plani i Komunikimit është një instrument përmes të cilit fuqizohen mekanizmat aktual të komunikimit dhe zhvillohen mekanizma të ri, shfrytëzimi i të cilëve do t'i ndihmojë Ministrisë në përmbushjen e misionit të ri, duke e siguruar mbështetjen e gjerë për reformën shëndetësore.

Përveç tjerash, përmes kësaj strategjie, Ministria e Shëndetësisë, synon të krijojë një kulturë të re të komunikimit brenda vet Ministrisë; Ministrisë me institucionet e tjera shëndetësore; dhe Ministrisë me publikun.

Kjo strategji ka për qëllim të promovojë me besim të ndërsjellë dialogun dhe komunikimi efikas midis këtyre niveleve për të adresuar qartë çështjet fundamentale që kanë të bëjnë me procesin e reformës shëndetësore dhe suksesin e saj.

Prof. Dr. Ferid Agani,

Ministër i Shëndetësisë

Hyrje

Qëllimi i komunikimit është të përcjellë informacionin në mënyrë që marrësi ta kuptojë atë siç duhet. Për një institucion publik komunikimi është jetik për të përmbushur misionin e tij.

Kjo strategji e komunikimit është projektuar për të mbështetur reformat aktuale në sektorin e shëndetësisë dhe përfshinë vitet 2013-2016.

Ministria e Shëndetësisë do ta marrë rolin e drejtuesit në sektorin shëndetësor, duke zhvendosur fokusin e saj nga menaxhimi operativ tek politikë-bërja, planifikimi strategjik dhe analizat.

Divizioni i Komunikimit me Publikun do të luaj rol kyç në procesin e reformës duke siguruar që të gjitha palët e përfshira ta kuptojnë, aprovojnë dhe mbështesin procesin e reformës. Kjo strategji do të fuqizojë mekanizmat ekzistues të komunikimit dhe do të zhvillojë mekanizma të ri në mënyrë që të ndihmojë MSh-në në përmbushjen e detyrave të saj.

Qëllimi i Planit të Komunikimit do të jetë të lehtësojë rrjedhën e informatës duke u fokusuar në tri fusha të komunikimit me qëllimet e tyre.

Objektivat e përgjithshme

Objektiva strategjike 1. Komunikimi i brendshëm

- Lehtësimi i analizave duke i bërë informatat relevante më të qasshme;
- Fuqizimi i stafit duke zhvilluar integrimin dhe identifikimin me MSh-në;
- Lehtësimi i reformave duke treguar domosdonë e tyre dhe dobitë e saj për tërë stafin.

Objektiva strategjike 2. Bashkëpunimi ndërinstytucional

- Rritja e transparencës së MSh-së;
- Mundësimi për pranimin e ndryshimeve në metodat e reja të punës në mesin e profesionistëve shëndetësor, me qëllim të eliminimit të shqetësimeve eventuale lidhur me reformat;
- Identifikimi i formave dhe mundësive për të shpërblyer institucionet shëndetësore dhe menaxhmentin e tyre me qëllim të udhëheqjes më të suksesshme dhe autonome të institucioneve.

Objektiva strategjike 3. Marrëdhënia me Publikun

- Avancimi i mëtejshëm i marrëdhënies me mediet, duke zbatuar qasje më pro-aktive të bazuar në besim reciprok, korrektësi dhe transparencë;
- Promovimi i aktiviteteve të MSh-së;
- Monitorimi i medieve;
- Përcjellja e brengave të popullatës në lidhje me sektorin shëndetësor dhe përgjigja adekuate nga ana e MSh-së.

Ky Plan bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore, në Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë (SSSh) 2010-2014 dhe Planin e saj të veprimit 2011-2014, si dhe në analizën e bërë në lidhje me gjendjen e komunikimit të brendshëm në MSh (realizuar më 2011).

Vizioni

Të përmirësojë imazhin publik dhe efikasitetin e MSh-së si dhe të sigurojë që popullata e Kosovës është e kënaqur me cilësinë e shërbimeve shëndetësore të ofruara.

Misioni

Të mbështes procesin e reformës duke përmirësuar rrjedhën e informatave të sakta dhe të përdorshme në mes të gjitha palëve të përfshira, në mënyrë që të sigurojë mbështetjen e tyre aktive në këtë proces.

Parimet e përgjithshme

Parimet e përgjithshme mbi të cilat është e ndërtuar ky Plan komunikimi janë:

- Barazia dhe jo-diskriminimi
- Saktësia
- Kredibiliteti
- Qartësia
- Koordinimi
- Transparenca
- Efikasiteti

Objektivat e përgjithshme

1. Komunikimi i brendshëm,
2. Ndërlidhja me institucionet shëndetësore dhe
3. Marrëdhëniet me publikun.

Objektiva strategjike 1. Komunikimi i brendshëm

Plani i Komunikimit të brendshëm është i bazuar në rezultatet dhe rekomandimet e dala nga anketa e komunikimit të brendshëm dhe nevojat e reja në komunikim që dalin nga roli i ri që MSh do ta luaj, siç është përcaktuar në SSSH.

Pasi që institucionet e Republikës së Kosovës kanë një histori relativisht të re dhe është e pranueshme gjerësisht nevoja për përmirësim për të arritur standardet evropiane, MSh do të luaj rol të ri në sektorin shëndetësor dhe në riorganizimin e MSh-së, që është vetëm një hap në përgatitjen për këtë rol.

Në këtë mënyrë, Plani i Komunikimit nuk do të përkrah vetëm prezantimin e organogramit të ri, por edhe planifikimin e mekanizmave të ri të komunikimit që do të ndihmojnë stafin e MSh-së në përmbushjen e detyrave të reja, e kështu t'i mundësojnë MSh-së të përmbushë rolin e saj të ri.

MSh do të kalojë nga qasja operative ku është e përfshirë drejtpërdrejt në menaxhimin e institucioneve shëndetësore në rol drejtues, ku do të përqendrohet në vendime strategjike dhe krijimin e politikave për të drejtuar sektorin shëndetësor në drejtimin e duhur.

Kjo qasje e re e orientuar kah shërbimi kërkon ndryshim të metodave të punës për të kryer detyrat e reja në MSh, do të ketë nevojë për fokus në politikë-bërje, planifikim strategjik, monitorim të performancës dhe analizim të dhënash.

Divizioni i Komunikimit Publik do të luaj rol qenësor që t'i mundësojë Ministrisë për t'i kryer këto detyra. Do t'i ofrojë Ministrisë të dhëna të besueshme dhe të freskëta mbi mendimet, brengat dhe dëshirat e pacientëve, popullatës dhe profesionistëve shëndetësor, duke i mundësuar Ministrisë të marrë vendime të bazuara në informata të sakta në lidhje me politikat dhe planifikimin strategjik. Për më tepër, do të promovojë aktivisht këto vendime në mesin e palëve kyçe të përfshira për të marrë mbështetjen e tyre për politikat e reja. Do të krijojë mekanizma komunikimi që lehtësojnë qasjen në informata të domosdoshme për përmbushjen e raporteve dhe analizave që do të prodhojë MSh-ja.

Objektivat specifike

1.1. Zhvillimi dhe implementimi i intranetit

Secili punëtor i MSh-së duhet të ketë qasje në intranet. Intraneti do të jetë mjet interaktiv ku të gjitha departamentet mund ta furnizojnë me informata relevante duke u mbikëqyrur dhe menaxhuar nga Divizioni i Komunikimit Publik.

Përmbajtja:

a) Informata organizative:

- Organogrami i MSh-së,
- Termat e referencës së departamenteve dhe pozitat,
- Agjenda e ngjarjeve të rëndësishme në MSh,
- Pasqyra e dhomave të konferencave,
- Kalendar, duke përfshirë edhe festat zyrtare, pushimet dhe udhëtimet studimore të stafit,
- Pasqyra e pjesëmarrjes së stafit në grupe punuese,
- Raportet rreth punimeve infrastrukturore të planifikuara brenda MSh dhe implikimet e tyre,
- Njoftime aktuale lidhur me funksionimin e shërbimeve tjera.

b) Rregullat, rregulloret dhe format e dokumenteve

- Kodi i veshjes,
- Rregullat për Cc,
- Kodi i sjelljes dhe etika profesionale,
- Rregullat dhe rregulloret e Ministrisë së Shëndetësisë,
- Format e dokumenteve zyrtare.

c) Lajme dhe aktivitete

- Lajmet e stafit (p.sh. takimet e tërë stafit, vizitat e ekspertëve, etj.)
- Lajmet e rëndësishme të sektorit të shëndetësisë (Hapja e spitaleve, miratimi i ligjeve shëndetësore, etj.)
- Raportet dhe fotot nga trajnimet, udhëtime studimore dhe aktiviteteve të tjera të departamenteve.

1.2. Organizimi i takimeve të rregullta

Takimet e rregullta do t'i mundësojnë stafit të luajnë një rol më aktiv në procesin e vendimmarrjes dhe të përmirësojnë komunikimin brenda MSh-së. Takimet e rregullta do ta ndihmojnë stafin në departamente për të kuptuar më qartë punën e departamenteve të tjera, si dhe do të lehtësojnë koordinimin dhe përkrahjen e punës ekipore në mes departamenteve.

Për më tepër, takimet do të paraqesin një mjet të mirë monitorues për drejtorët të cilët do të jenë në gjendje për të vlerësuar rregullisht nivelin e avancimit të stafit të tyre.

1.3. Informimi përmes ekraneve

Qëllimi kryesor i informimit përmes ekraneve është të informojë stafin dhe vizitorët me aktivitetet dhe zhvillimet më të reja dhe më të rëndësishme në MSh. Kjo metodë mund të shërbejë, gjithashtu, për shpërndarjen e informatave nga materialet promovuese dhe edukative. Vendndodhja e këtyre ekraneve duhet të sigurojë qasje të lehtë. Divizioni i Komunikimit Publik duhet të administrojë me informatat që do të plasohen në ekran dhe të bëjë përditësimin e tyre.

1.4. Përgatitja dhe ofrimi i pakos informative për të punësuarit në MSh

Të gjithë të punësuarit dhe ata që do të punësohen si të ri brenda MSh-së, do të pajisen me një pako informative, në të cilën do të jenë të gjitha informatat e nevojshme për punën dhe obligimet që dalin nga marrëdhënia e punës.

Objektiva strategjike 2. Bashkëpunimi ndërinstytucional

Ministria e Shëndetësisë realizon komunikime të rregullta me të gjitha institucionet shëndetësore dhe partnerët e saj. Këtë komunikim e realizon përmes takimeve të rregullta, këmbimit të informatave elektronike, raporteve të rregullta dhe me kërkesë, si dhe hulumtimeve me qëllim të përcjelljes së brengave të punëtorëve shëndetësor lidhur me çështje aktuale shëndetësore.

Ky komunikim bazohet në ligjet ekzistuese në fuqi si dhe rregulloret e brendshme të institucioneve dhe ka për qëllim të përparojë nivelin e komunikimit në mes të institucioneve shëndetësore dhe jo shëndetësore të gjitha niveleve.

Reforma e sektorit shëndetësor do të ndryshojë raportin në mes të MSh-së dhe institucioneve të tjera shëndetësore, pasi që roli i MSh-së nuk do të jetë menaxhimi i deri-

atëherë institucioneve shëndetësore të pavarura. MSh do të përqendrohet në monitorimin e performancës dhe identifikimin e formave dhe mundësive për të shpërblyer institucionet shëndetësore dhe menaxhmentin e tyre, me qëllim të udhëheqjes më të suksesshme dhe autonome të institucioneve.

Divizioni i Komunikimit Publik do të luaj një rol të rëndësishëm në futjen e mekanizmave të duhur të komunikimit për të mbajtur lidhjen e sektorit shëndetësor dhe për të siguruar se të gjitha institucionet shëndetësore shkojnë në të njëjtin drejtim. Për këtë, është gjithashtu e nevojshme të përcillen mendimet, brengat dhe kërkesat e profesionistëve shëndetësor dhe të sigurohet përkrahja e tyre për reformën shëndetësore.

Objektivat specifike

2.1. Fuqizimi i takimeve të rregullta me vartësit dhe ndërmjet vartësve

MSh me institucionet vartëse mban takime të rregullta me qëllim të ngritjes së shkallës së informimit lidhur me aktualitetet brenda institucioneve dhe MSh-së. Njëkohësisht, me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit dhe efikasitetit të ndërsjellë, përmes takimeve të rregullta, institucionet shëndetësore realizojnë komunikime të rregullta.

2.2. Përmirësimi i raportimit të rregullt

Institucionet raportojnë rregullisht për çështjet me rëndësi si për Ministrinë ashtu edhe për institucionet e tjera. Këto raportime duhet të jenë periodike dhe i shërbejnë institucioneve për të shtuar transparencën dhe lehtësuar vendimmarrjen.

2.3. Zhvillimi i faqeve të internetit të institucioneve

Ueb faqet e institucioneve publike duhet të përmbajnë një minimum të informatave dhe dukje të standardizuar të përshkruar nga ana e MSh-së me akt të veçantë bazuar në legjislacionin në fuqi. Përmes përditësimit të informatave të publikuara në faqet e internetit, MSh-ja dhe institucionet zhvillojnë komunikimin ndërinstitutional.

Objektiva strategjike 3. Marrëdhënia me publikun

Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet shëndetësore, realizojnë marrëdhënie me publikun si element thelbësor të funksionimit efikas dhe transparent. Kjo marrëdhënie realizohet me qëllim të sensibilizimit dhe informimit rreth situatës reale, edukimit, rritjes së

besueshmërisë dhe përparimit të marrëdhënieve me qytetarët, partnerët, mediat, shoqërinë civile dhe grupet e tjera të interesit.

Divizioni i Komunikimit Publik do të jetë përgjegjës në adresimin e brengave të popullatës në lidhje me sektorin shëndetësor dhe të ofrojë përgjigje adekuata nga ana e MSh-së.

Do të sugjerojë hulumtime brenda shfrytëzuesve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor lidhur me nivelin e kënaqshmërisë së popullatës me shërbimet shëndetësore dhe çështje tjera që lidhen me sektorin shëndetësor. Kjo do të mundësojë mbështetjen e MSh-së për të bërë zgjedhje të politikave të bazuara në informatë, me qëllim të arritjes së kënaqshmërisë më të lartë të mundshme të popullatës me shërbimet shëndetësore.

Objektivat specifike

- 3.1. Ridizajnimi dhe avancimi i mëtejshëm i faqes së internetit të MSh-së,
- 3.2. Krijimi i press-alerteve dhe materialeve informuese,
- 3.3. Lehtësimi i qasjes në dokumente zyrtare bazuar në ligjin përkatës,
- 3.4. Organizimi i takimeve të rregullta me mediat,
- 3.5. Organizimi i Forumit të qytetarëve dhe aktivitetet tjera informuese me publikun

4. Sigurimi i vijës buxhetore për komunikim

Brenda MSh-së dhe institucioneve shëndetësore duhet të krijohet vijë e ndarë buxhetore për të mbështetur aktivitetet që dalin nga kjo strategji.

5. Monitorimi dhe evaluimi

Divizioni i Komunikimit Publik do të jetë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kësaj strategjie. Përmes analizimit të numrit dhe kualitetit të informatave, publikimeve, krijimit të faqeve të internetit, raportit për numrin e kërkesave të shqyrtuara për qasje në dokumente zyrtare, numrit të fushatave, etj., si dhe rishikimit të rregullt të informatave (Press- review) dhe hulumtimeve, do të vlerësojë rrjedhën e procesit të komunikimit dhe informimit në mënyrë që këtë aktivitet ta avancojë dhe përshtat nevojave dhe kërkesave.

Përfundim

Plani i Komunikimit vjen në një moment adekuat, sepse MSh tashmë është duke kaluar nëpër një proces reformash.

Miratimi i Ligjit të ri të Shëndetësisë, Ligjit për Kontrollin e Duhanit, Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe hartimi i disa ligjeve të tjera që janë në procedurë të miratimit si Projektligji për Sigurime Shëndetësore dhe të tjera, kërkon që Plani i komunikimit të për afrohet plotësisht me procesin aktual të reformave dhe MSh duhet të sigurohet që kjo reformë të kuptohet drejt dhe të shkojë në drejtimin e duhur. Qëndrueshmëria e Planit duhet të sigurohet edhe më tej nga fakti se ajo është e bazuar në rezultatet e një hulumtimi të realizuar lidhur me komunikimin e brendshëm në Ministrinë e Shëndetësisë.

Fillimi i përdorimit të intranetit do të shënojë një hap të rëndësishëm drejt formalizimit të komunikimit të brendshëm dhe takimeve javore të departamenteve, që duhet të nxisin punën ekipore, koordinimin dhe angazhimin e stafit brenda MSH.

Monitorimi dhe evaluimi i aktiviteteve të palëve kyçe, të përfshira në proces të komunikimit, do t'i mundësojë MSH-së të sjell vendime të bazuara në evidencë, që do ta ngre kredibilitetin e MSh-së.

Plani i veprimit i Planit të komunikimit të Ministrisë së Shëndetësisë

OBJEKTIVA 1 - Komunikimi i brendshëm						
Objektiva specifike 1.1- Zhvillimi dhe implementimi i intranetit						
Aktivitetet	Indikatorët	Kostoja e zbatimit	Bartës i kostos	Institucioni udhëheqës	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Afati kohor
1. Dizajnimi dhe instalimi i intranetit	Intraneti funksional	5 000 -	MSh /Lux - Dev	MSh / Dep. për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	Ligji për administratën shtetërore, Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011	K1. 2014
2. Trajnimi i stafit për administrimin e intranetit	Numri i stafit të trajnuar	4 X 250 EUR	MSh/Lux - Dev	MSh / Dep. për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, Divizioni i Komunikimit Publik		2014

3. Trajnimi i stafit për përdorimin e intranetit	Numri i stafit të trajnuar	100 EUR	MSh/Lux-Dev	MSh / Dep. për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, Divizioni i Komunikimit Publik		2014
4. Hartimi i rregullores së brendshme për administrimin e intranetit	Rregullorja e brendshme e miratuar	500 EUR	MSh	MSh / Divizioni i Komunikimit Publik	Ligji për administratën shtetërore, Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011	2014

Objektiva specifike 1.2 - Organizimi i takimeve të rregullta

Aktivitetet	Indikatorët	Kostoja e zbatimit	Bartës i Kostos	Institucioni udhëheqës	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Afati kohor
1. Përcaktimi i dinamikës së takimeve	Plani dinamik i përcaktuar	500 EUR	MSh	MSh	Ligji për administratën shtetërore, Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011	2014
2. Përcaktimi i përmbajtjes dhe pjesëmarrësve	Plani i përpiluar i përmbajtjes dhe pjesëmarrësve	500 EUR	MSh	MSh	Ligji për administratën shtetërore, Ligji për Shërbimin Civil në Kosovë, Rregullorja për shërbimin e Komunikimit qeveritar 03/2011	2014

3. Hartimi i rregulloreve të takimeve	Rregullorja e hartuar	1 000 EUR	MSh	MSh	Ligji për administratën shtetërore, Ligji për Shërbimin Civil në Kosovë, Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/201	2014
---------------------------------------	-----------------------	-----------	-----	-----	---	------

Objektiva specifike 1.3 Informimi përmes ekraneve						
Aktivitetet	Indikatorët	Kostoja e zbatimit	Bartës i kostos	Institucioni udhëheqës	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Afati kohor

1. Sigurimi i pajisjeve të nevojshme dhe instalimi i tyre	Pajisjet e siguruara	5 000 EUR	Lux-Dev	MSh / Divizioni i Komunikimit Publik, Dep. për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, MAP		2014
2. Sigurimi i softverit adekuat	Softveri i siguruar	3 000 EUR	Lux-Dev	MSh /MAP		2014
3. Trajnimi i stafit për administrimin e ekraneve	Numri i stafit të trajnuar	500 EUR	Lux-Dev	MSh /Divizioni i Komunikimit Publik, Dep. për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme		2014

OBJEKTIVA 2- Bashkëpunimi ndërinstytucional

Objektiva specifike 2.1- Vazhdimi i takimeve të rregullta me vartësit dhe ndërmjet vartësve

Aktivitetet	Indikatorët	Kostoja e zbatimit	Bartës i kostos	Institucioni udhëheqës	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Afati kohor
Përcaktimi i dinamikës së takimeve	Plani dinamik i përcaktuar	500 EUR	MSh	MSh me vartësit	Ligji për administratën shtetërore, Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011,	2013
1. Përcaktimi i përmbajtjes dhe pjesëmarrësve	Plani i përpiluar i përmbajtjes dhe pjesëmarrësve	500 EUR	MSh	MSh me vartësit	Ligji për administratën shtetërore, Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011,	2013

2. Hartimi i rregulloreve të takimeve	Rregullorja e hartuar	1 000 EUR	MSh	MSh me vartësit	Ligji për administratën shtetërore, Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011	2013
3. Takimet e rregullta ndërinstucionale për çështjet me interes të përbashkët	Numri i takimeve të realizuara	10 000 EUR	MSh, Qeveria, donatorët	MSh, Qeveria, vartësit, donatorët	Ligji për administratën shtetërore, Ligji për shërbimin civil	Në vazhdimësi
Objektiva specifike 2.2- Raportimi i rregullt						
Aktivitetet	Indikatorët	Kostoja e zbatimit	Bartës i kostos	Institucioni udhëheqës	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Afati kohor

1. Përcaktimi i dinamikës së raportimeve	Plani dinamik i përcaktuar	500 EUR	MSh	MSh me vartësit	Ligji për administratën shtetërore, Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011, Ligji i punës, Ligji i shërbimit civil	2014
2. Përcaktimi i përmbajtjes, formës dhe përgjegjësve	Plani i përpiluar i përmbajtjes, formës dhe përgjegjësve	5 000 EUR	MSh	MSh me vartësit	Ligji për administratën shtetërore, Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011, Ligji i punës, Ligji i për shërbimin civil	2014

3. Hartimi i rregulloreve të raportimit	Rregullorja e hartuar	1 000 EUR	MSh	MSh me vartësit	Ligji për administratën shtetërore, Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011, Ligji i punës, Ligji i shërbimit civil	2014
4. Raportimi i të gjitha institucioneve të licencuara	Numri i raporteve të dërguara	500 EUR	MSh	Institucionet e licencuara	Ligji për Shëndetësi	Në vazhdimësi

Objektiva specifike 2.3 - Zhvillimi i faqeve të internetit të institucioneve

Aktivitetet	Indikatorët	Kostoja e zbatimit	Bartës i kostos	Institucioni udhëheqës	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Afati kohor
1. Krijimi dhe funksionalizimi i faqeve të internetit	Faqet e internetit të krijuara dhe funksionale	10 000 EUR	MSh, institucionet përkatëse + Lux-Dev	MSh, institucionet përkatëse	Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011; UA për ueb faqet zyrtare të institucioneve	2014
2. Krijimi i templateve standarde dhe trajnimi i stafit për përdorimin dhe mirëmbajtjen e faqes së internetit	Templatet e krijuara dhe numri i stafit të trajnuar	3 000 EUR	MSh, institucionet përkatëse /Lux-Dev	MSh, institucionet përkatëse	Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011, UA për ueb faqet zyrtare të institucioneve qeveritare	2013

<p>3. Përditësimi i faqeve të internetit të institucioneve shëndetësore</p>	<p>Numri i publikimeve në faqet e internetit, numri i klikimeve</p>		<p>MSh, institucionet përkatëse</p>	<p>MSh, institucionet përkatëse</p>	<p>Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011, UA për ueb faqet zyrtare të institucioneve qeveritare</p>	<p>Në vazhdimësi</p>
---	---	--	---	---	--	----------------------

OBJEKTIVAT 3- Marrëdhënia me publikun**Objektiva specifike 3.1 - Avancimi i faqes së internetit**

Aktivitetet	Indikatorët	Kostoja e zbatimit	Bartës i kostos	Institucioni udhëheqës	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Afati kohor
1. Avancimi i faqes së internetit të MSh-së	Numri i publikimeve në faqet e internetit, numri i klikimeve		Lux-Dev	MSh	Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011, UA për ueb faqet zyrtare të institucioneve qeveritare	2013 dhe në vazhdimësi

<p>2. Avancimi i faqes së internetit të institucioneve tjera</p>	<p>Numri i publikimeve në faqet e internetit, numri i klikimeve</p>		<p>MSh, institucionet përkatëse</p>	<p>MSh, institucionet përkatëse</p>	<p>Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011, UA për ueb faqet zyrtare të institucioneve qeveritare</p>	<p>Në vazhdimësi</p>
<p>3. Trajnimi i stafit për përdorimin dhe mirëmbajtjen e faqes së internetit të MSh-së</p>	<p>Numri i stafit të trajnuar</p>	<p>1 000 EUR</p>	<p>MSh</p>	<p>MSh</p>	<p>Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011, UA për ueb faqet zyrtare të institucioneve qeveritare</p>	<p>2013</p>

4. Krijimi i vegzave të reja me institucione relevante	Numri i vegzave të krijuara	1 000 EUR	MSh, institucionet përkatëse	MSh, institucionet përkatëse	Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011, UA për ueb faqet zyrtare të institucioneve qeveritare	Në vazhdimësi
--	-----------------------------	-----------	------------------------------	------------------------------	---	---------------

Objektiva specifike 3.2 - Krijimi i press-alerteve dhe materialeve informuese

Aktivitetet	Indikatorët	Kostoja e zbatimit	Bartës i kostos	Institucioni udhëheqës	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Afati kohor
-------------	-------------	--------------------	-----------------	------------------------	--------------------------------------	-------------

1. Përpilimi i rregullt i komunikatave për media	Numri i komunikatave për media	500 EUR	MSh, institucionet përkatëse dhe Lux-Dev	MSh, institucionet përkatëse	Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011	Në vazhdimësi
2. Përpilimi i materialeve informuese	Numri i materialeve informuese	10 000 EUR	MSh, institucionet përkatëse dhe Lux - Dev	MSh, institucionet përkatëse	Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011	Në vazhdimësi

Objektiva specifike 3.3 - Lehtësimi i qasjes në dokumente zyrtare

Aktivitetet	Indikatorët	Kostoja e zbatimit	Bartës i koston	Institucioni udhëheqës	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Afati kohor
1. Emërimi i personave përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasjen në dokumentet publike	Zyrtarët e emëruar		MSh	MSh, institucionet përkatëse	Ligji për qasjen në dokumente publike	2013
2. Formimi i komisioneve për shqyrtim të kërkesave për qasjen në dokumente publike	Komisionet e emëruara		MSh, institucionet përkatëse	MSh, institucionet përkatëse	Ligji për qasjen në dokumente publike	2013

3. Përpilimi i raporteve të rregullta rreth kërkesave për qasjen në dokumente publike	Numri i raporteve të përpiluara		MSh, institucionet përkatëse	MSh, institucionet përkatëse	Ligji për qasjen në dokumente publike	2013 dhe në vazhdimësi
---	---------------------------------	--	------------------------------	------------------------------	---------------------------------------	------------------------

Objektiva specifike 3.4 – Takimet e rregullta me media						
Aktivitetet	Indikatorët	Kostoja e zbatimit	Bartës i kostos	Institucioni udhëheqës	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Afati kohor
1. Përcaktimi i dinamikës së takimeve me media	Plani dinamik i përcaktuar	500 EUR	MSh	MSh me vartësit	Ligji për administratën shtetërore, Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011	2013 dhe në vazhdimësi

2. Përcaktimi i përmbajtjes dhe pjesëmarrësve	Plani i përpiluar i përmbajtjes dhe pjesëmarrësve	500 EUR	MSh	MSh me vartësit	Ligji për administratën shtetërore, Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011	Në vazhdimësi
3. Trajnimi i zyrtarëve të MSh-së dhe institucioneve përkatëse rreth punës me media	Numri i zyrtarëve të trajnuar	10 000 EUR	MSh, institucionet përkatëse	MSh, institucionet përkatëse/+ Lux-Dev	Ligji për administratën shtetërore, Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011	Në vazhdimësi

Objektiva specifike 3.5. Forumi i qytetarëve dhe aktivitetet tjera informuese me publikun

Aktivitetet	Indikatorët	Kostoja e zbatimit	Bartës i kostos	Institucioni udhëheqës	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Afati kohor
1. Organizimi i takimeve të rregullta me qytetarët	Numri i takimeve të organizuara	100 EUR	MSh	MSh	Ligji për të drejtat dhe obligimet e qytetarëve në kujdesin shëndetësor, Ligji për qasjen në dokumente publike	Në vazhdimësi

2. Përgatitja për përgjigje në kërkesat e qytetarëve	Numri i përgjigjeve të përgatitura	/	MSh	MSh	Ligji për të drejtat dhe obligimet e qytetarëve në kujdesin shëndetësor, Ligji për qasjen në dokumente publike	Në vazhdimësi
3. Përpilimi i materialeve informuese	Numri i materialeve informuese	1 000 EUR	MSh, institucionet përkatëse	MSh, institucionet përkatëse	Ligji për të drejtat dhe obligimet e qytetarëve në kujdesin shëndetësor, Ligji për qasjen në dokumente publike, Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011	Në vazhdimësi

4. Përgatitja e shtandit informativ	Shtandi i vendosur dhe i furnizuar me materiale informative	500 EUR	MSh	MSh	Ligji për të drejtat dhe obligimet e qytetarëve në kujdesin shëndetësor, Ligji për qasjen në dokumente publike, Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011	2013
-------------------------------------	---	---------	-----	-----	--	------

Objektivat Strategjike 4 - Definimi i vijës buxhetore për komunikim

Aktivitetet	Indikatorët	Kostoja e zbatimit	Bartës i kostos	Institucioni udhëheqës	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Afati kohor
1. Ndarja e vijës buxhetore të veçantë për komunikim brenda MSh-së	Mjetet e ndara për zhvillimin e aktiviteteve të komunikimit	/	MSh	MSh	Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011, Ligji për menaxhimin e financave publike	2013-2016

Objektivat Strategjike 5: Monitorimi dhe evaluimi

Aktivitetet	Indikatorët	Kostoja e zbatimit	Bartës i kostos	Institucioni udhëheqës	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Afati kohor
1. Krijimi i mekanizmave për monitorim dhe evaluim	Udhërrëfytyesi për monitorim dhe evaluim i përpiluar	1000	MSh	MSh/ Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, Divizioni i Komunikimit Publik, Departamenti për Zhvillim Strategjik Shëndetësor	Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011	Në vazhdimësi

2. Përcaktimi i indikatorëve të monitorimit dhe evaluimit	Udhërrëfyesi i indikatorëve të monitorimit dhe evaluimit	/	MSh	MSh/ Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, Divizioni i Komunikimit Publik, Departamenti për Zhvillim Strategjik Shëndetësor	Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011	Në vazhdimësi
3. Emërimi i zyrtarit përgjegjës për monitorim dhe evaluim	Zyrtari i emëruar	/	MSh	MSh	Rregullorja për shërbimin e komunikimit qeveritar 03/2011	2014